

SHQIPËRIA NË DOKUMENTET AUSTRO-HUNGAREZE

---

V I T I 1 9 1 4



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE  
Instituti i Historisë

# **SHQIPËRIA NË DOKUMENTET AUSTRO-HUNGAREZE**

**(1914)**

## **VËLLIMI VII**

**(gusht - shtator)**

**Përgatitja dhe redaktimi**

**Akademik MARENGLLEN VERLI**

**Prof. dr. FATMIRA RAMA**

**Prof. dr. FATMIRA MUSAJ**

Tiranë, 2020

**Drejtues i Projektit:**

Akademik Marenglen VERLI

Akademik Vaso TOLE

**Recensentë:**

Prof. dr. Ksenofon KRISAFI, Prof. dr. Valentina DUKA

**Konfrontimi dhe korrektimi letrar:**

Meliha BALLA

**Radhitja:**

Meliha BALLA, Mirela MIHALI, Enkelejda MISHA

**Arti Grafik & Treguesi i emrave:**

Mirela MIHALI

MIRATUAR NË GRUPIN E PROJEKTTIT

© Copyright: ASA - Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe përgatitësit

ISBN

ISBN

Botimet albanologjike

## PARATHËNIE

Publikimi i dokumenteve historike për të kaluarën e shqiptarëve ka qenë dhe mbetet një detyrë e rëndësishme për historianët. Një gjë e tillë paraqitet veçanërisht e domosdoshme kur është fjala për ngjarje dhe dukuri me domethënie të jashtëzakonshme në historinë e shqiptarëve siç janë edhe ngjarjet e vitit 1914.

Viti 1914 është nga më të rëndësishmit në historinë moderne të kombit shqiptar. Ai nisi me përpjekjet e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit për të përcaktuar terrenin për ardhjen e Princ Wied-it në Shqipëri, vijoi me dy rebelimet që tronditën nga themelet shtetin e ri shqiptar dhe përfundoi me kthimin e vendit në fushë betejash dhe okupimin nga disa ushtri të huaja. Ngjarjet e muajve të fundit të vitit 1914, zhbënë atë që u arrit me shumë mund gjatë viteve 1912-1913, likuiduan Shqipërinë e pavarur dhe asnjëse.

Për vetë peshën që ngjarjet e këtij viti mbartin, ato kanë qenë dhe janë objekt i një vëmendjeje të veçantë në letërsinë historike shqiptare dhe të huaj. Krahas studimeve të mirëfillta, një vend të rëndësishëm në përpilimin e sfondit historik zënë edhe burimet dokumentare të arkivave të shteteve të huaja, politika e të cilëve ka qenë e lidhur drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me Shqipërinë e shqiptarët. Në këtë kuadër, dokumentet diplomatike austro-hungareze, janë një burim tejet i vlefshëm, në saje të të cilit ndriçohen deri në detaje lëvizjet politike e kulturore të shqiptarëve, si dhe qëndrimi i faktorit ndërkombëtar ndaj çështjes shqiptare.

Në Arkivin e Institutit të Historisë pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike, ruhet një fond i rëndësishëm i dokumenteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë (Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien).

Zgjedhja për botim e këtij fondi, nuk ka qenë e rastit.

Së pari, ky fond përbën një nga seksionet më të kompletuara të Arkivit të Institutit të Historisë. Ai ka filluar të formohet që në vitet 30 me prurjet

që synonin t'i shërbenin organizimit të festimeve të 25-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe u pasurua në përmasat që zotërojmë sot në vitet 50-70, nën kujdesin e posaçëm të prof. Aleks Budës. Dokumentet e këtij fondi i kemi në shqip në saje të punës së kujdesshme dhe tejet të përkushtuar të një grupi përkthyesish: Veniamin Dashi, Henrik Lacaj, Maksut Shehu, Aleksandër Hivziu, Shefqet Hoti, Bexhet Shehu, Pjetër Rodiqi, Tomor Dani, Sh. Koka, J. Nuraj etj.

Së dyti, diplomacia austro-hungareze e fillimshekullit ishte nga më aktivet në rajon, madje në një hark kohor prej disa dhjetërvjeçarësh, që përfshin edhe periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare edhe vitet pas Shpalljes së Pavarësisë deri në vitin 1918. E interesuar posaçërisht për Ballkanin, Perandoria Habsburgase shikonte me vëmendje të veçantë zhvillimet në trevat shqiptare, të cilat lakmoheshin nga shtetet e vogla ballkanike. Në këtë kuadër Perandoria ishte e pranishme me përfaqësi të shumta diplomatike në këto treva. Përveç ambasadës në Kostandinopojë, ajo kishte kryekonsullata në qendrat e katër vilajeteve shqiptare, përkatësisht Shkodër, Manastir, Janinë e Shkup dhe konsullata në shumë qytete të tjerë. Me krijimin e shtetit shqiptar dhe me vendosjen në krye të tij të Princ Wied-it, në Durrës dhe në Vjenë u hapën edhe legatat respektive. Përfaqësues të Austro-Hungarisë gjendeshin edhe në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit që vepronte në Shqipëri, si dhe në sektorë të ndryshëm të administratës civile dhe ushtarake të vendit. Në vitet e Luftës së Parë Botërore, veçanërisht në vitet 1916-1918 prania e austro-hungarezëve në Shqipëri, natyrisht do të ishte masive në të gjithë viset veriore deri në luginën e Vjosës ku u shtri zona respektive e pushtimit nga armata e Perandorisë Habsburge.

Së treti, raportet konsullore austro-hungareze dallohen nga pikëpamja e thellësisë dhe gjerësisë së informacionit historik që serviret. Dokumentet, natyrisht, kanë edhe nota subjektivizmi por përsëri informacioni që na përcjellin është shumë i vyer, aq më tepër për arsye se diplomatët e Vjenës ishin njerëz të mirëarsimuar, njohës të profesionit të vet, me shumë përvojë. Njëherësh ata kishin në dispozicion mjete të rëndësishme monetare, që u siguronin në terren njohje të gjera dhe informacione nga burime të rëndësishme vendase.

Së katërti, i rëndësishëm për t'u theksuar është fakti se ky informacioni mbulon tërë hapësirën shqiptare, madje edhe vendet fqinje, ndodhitë e të cilave lidhen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me zhvillimet në vilajetet shqiptare. Një gjë e tillë shërben më së miri që lexuesit të krijojnë perceptime të sakta për ngjarje a dukuri të caktuara dhe më tej të qartësohen edhe për një kontekst më të gjerë të realitetit historik në vitin 1914.

Në dokumentet në fjalë gjenden të dhëna për tiparet e shqiptarëve, për virtytet dhe veset e tyre, madje sipas krahinave të ndryshme, mandej të dhëna për numrin dhe shtrirjen e tyre në planin etnik, për aftësitë e tyre, për nivelin e zhvillimit ekonomik, social, për aspiratat politike, për situatën arsimore e kulturore, për botimet në gjuhën shqipe, etj. Perandoria Dualiste ishte e interesuar të kishte një informacion për gjithçka, duke përfshirë edhe politikën e shteteve ballkanike dhe të Fuqive të Mëdha me interesa në rajon, sepse mbi këtë bazë ndërtonte politikën dhe mbronte interesat e saj gjeostrategjike.

Sa i përket vitit 1914, ky fond ka të dhëna me interes për ngjarje, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë lidhen me ardhjen dhe veprimtarinë e Princ Wied-it në Shqipëri si monark i shtetit të ri shqiptar, i njohur ndërkombëtarisht nga të gjithë Fuqitë e Mëdha, me rebelimet kundër tij, me fillimin e Luftës së Parë Botërore dhe me veprimet ushtarake në territorin e shtetit shqiptar etj. Në këtë kuadër jepen informacione interesante për lëvizjet politike të shqiptarëve, veprimet e armatosura në të gjitha trevat shqiptare, shqetësimin e ankthin, veçanërisht në elitën politike shqiptare për të mos humbur mbështetjen në radhët e faktorit ndërkombëtar dhe për të mbajtur larg ushtritë e fqinjëve etj. Në konstelacionin e zhvillimeve politike dhe ushtarake të kohës, lëvrijnë edhe një mori personalitetesh politike shqiptare dhe të huaja të niveleve të ndryshme.

Dokumentet e këtij vëllimi përfshijnë periudhën 1 gusht deri më 30 shtator 1914, përveç rastit të publikimit të mbledhjeve të Këshillit të Konsujve në Shkodër, të cilat jepen në vazhdimësi edhe për muajt në vijim, për të mos shkëputur artificialisht informacionin. Në dokumentet e vëllimit jepen të dhëna interesante për zhvillimin e rebelimit antishtetëror në Shqipërinë e Mesme dhe tjetrit në Shqipërinë e Jugut, të lëvizjes së ashtuquajtur “vorioepirote”, për ndikimin e tyre në shkatërrimin e themeleve të shtetit shqiptar, për grupimet që morën pjesë në to, mbi qëndrimin e qeverisë shqiptare dhe të Princ Wied-it ndaj tyre, mbi qëndrimin që mbajtën krerë të ndryshëm shqiptarë dhe mbi pasojat e rënda që patën ato për kombin dhe shtetformimin në Shqipëri. Këto dokumente dëshmojnë gjithashtu edhe për pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë në prag të Luftës Botërore, dhe në javët e para të zhvillimit të saj. Veçanërisht politika e Fuqive të Adriatikut, Italisë e Austro-Hungarisë zë një vend qendror në këtë vëllim, kur ekuilibri i brishtë u shkrëmoq, Wied-i u detyrua të largohej nga Shqipëria dhe vendin e përfshiu kaosi.

Të dhëna interesante përmban ky vëllim edhe për veprimtarinë në këtë periudhë të krerëve politikë shqiptarë si Ismail Qemali, Esat Pashë Toptani, Preng Bib Doda, Aziz Vrioni, Syrja Vlora etj.

Gjatë përgatitjes për botim është treguar një kujdes i veçantë që përmbajtja e dokumenteve të jepet e saktë, e qartë, duke e afruar gjuhën e përkthimit me atë letrare dhe duke ruajtur sa të ishte e mundur stilin e përkthyesit. Hera-herës është ndërhyrë edhe me shënime e sqarime plotësuese brenda në tekst ose në fund të tij. Dokumentet botohen të plota me përjashtim të rasteve kur teksti në origjinal ka qenë i palexueshëm ose i fshirë, si edhe në ndonjë rast kur është vlerësuar se informacioni nuk ka pasur lidhje me botën shqiptare.

Së fundmi, është një kënaqësi t'u shprehet falënderim dhe mirënjohje studiuesve të gjeneratave të ndryshme të Institutit të Historisë, të cilët u angazhuan për pasurimin e fondeve të Arkivit të këtij Instituti me dokumentet diplomatike të Arkivit të Vjenës, si edhe, aktualisht me publikimin e tyre sipas kriterëve shkencore bashkëkohore. Një falënderim e nderim i veçantë u shkon edhe përkthyesve, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar për sjelljen në shqip të dokumenteve që po shohin sot dritën e botimit.

Së fundi, nuk mund të mos përmendim angazhimin në kryerjen e një sërë procesesh të rëndësishme për përgatitjen e vëllimit për botim të znj. Meliha Balla, Mirela Mihali dhe Enkelejda Misha, të cilat meritojnë një falënderim të veçantë.

**Përgatitësit**



## PASQYRA E LËNDËS

1. Njoftim i konsullit austro-hungarez në Korfuz për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, lidhur me mbërritjen atje të një anijeje luftarake në dispozicion të përfaqësuesit rus në qeverinë shqiptare  
*1 gusht 1914* 71
2. Shkresë e Ministrisë së Luftës në Vjenë në lidhje me kërkesën e Theodor Graserit për organizimin e një legjioni të huajve, në ndihmë të Princ Wied-it  
*1 gusht 1914* 72
3. Informacion i markezit Pallavicini, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë për një kryengritje në Serbinë e Re  
*Jenikoj, më 1 gusht 1914* 72
4. Telegram i Rappaport-it drejtuar baronit Conrad në Vjenë, në lidhje me një kryengritje të malësorëve të Shkodrës kundër Malit të Zi  
*Vjenë, më 1 gusht 1914* 73
5. Informacion i nënkonsullit në Vlorë, Mayerhauser, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, Berchtold, rreth sulmit të trupave të rebelëve të Shqipërisë së Mesme në teqenë bektashiane të Gllavës dhe për dështimin e tij  
*Vlorë, më 1 gusht 1914* 74
6. Ministria e Punëve të Jashtme në Vjenë është dakord me Ministrinë e Luftës, për tërheqjen e anijeve nga ujërat detare të Shqipërisë  
*Vjenë, më 1 gusht 1914* 74

7.  
Informacion drejtuar Vjenës, i Seksionit të Marinës në Pola, për tërheqjen e anijeve (njësive) nga Shqipëria  
*Vjenë, më 1 gusht 1914* 75
8.  
Informacion i Ministrisë së Luftës në Vjenë, për ambasadorin austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini, për tërheqjen e anijeve të bllokut ushtarak të Antantës nga Shqipëria  
*Vjenë, më 1 gusht 1914* 75
9.  
Shkresë e Ministrisë së Jashtme austro-hungareze, drejtuar Ministrisë së Luftës, për tërheqjen e dy detashmenteve ushtarake nga Shkodra  
*Vjenë, më 1 gusht 1914* 76
10.  
Raportim i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Halla, drejtuar ministrit të Jashtëm Berchtold, Vjenë, në lidhje me riorganizimin ushtarak dhe administrativ të qytetit të Shkodrës, mbas largimit të detashmentit anglez dhe kryekomandantit e administratorit të Shkodrës, kolonelit Philips  
*Shkodër, më 1 gusht 1914* 77
11.  
Telegram i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, drejtuar trupit diplomatik në Berlin, Romë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë, për tërheqjen e anijeve të Antantës nga Shkodra dhe për shkëmbimin e pikëpamjeve me qeverinë gjermane dhe italiane  
*Vjenë, më 1 gusht 1914* 79
12.  
Telegram nga Ministria e Punëve të Jashtme, drejtuar konsullatës austro-hungareze në Shkodër, për regjistrimin e disa pagesave  
*Vjenë, më 2 gusht 1914* 80
13.  
Raport i konsullit austro-hungarez në Shkodër, drejtuar ministrit të Jashtëm Berchtold, për largimin e konsullit të mëparshëm italian dhe ardhjen e konsullit të ri Galli, si dhe për një atmosferë jo miqësore ndaj italianëve, në disa mjedise të qytetarëve në Shkodër  
*Shkodër, më 2 gusht 1914* 80

- 
14. Telegram i konsullit Para nga Korfuzi rreth një informacioni të Mehmet Konicës, i dërguar i Shqipërisë në Athinë, për bisedime në Beograd nga dy shqiptarë me ndikim në rrethe të caktuara në vend, për përkrahjen e kandidaturës së një princi serb në fronin e Shqipërisë  
*Korfuz, më 2 gusht 1914* 82
15. Porosi konfidenciale e Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, për diplomatin e vet në Durrës, Lövental-in , që të mos krijojë probleme me italianët, për arsye të larta politike  
*Vjenë, më 2 gusht 1914* 82
16. Shkresë e delegatit austro-hungarez në Komisionin për Caktimin e Kufirit në Shqipërinë e Veriut, kolonelit Mietzl, dërguar qeverisë së tij, për dërgimin e protokollit rreth veprimtarisë së Komisionit të Kufijve të Veriut në periudhën 2 korrik - 29 korrik 1914  
*Vjenë, më 2 gusht 1914* 83
17. Informacion nga konsullata austro-hungareze në Korfuz, për një qytetar shqiptar që ishte dërguar në Budapest nga qeveria e Durrësit për të blerë kuaj  
*Korfuz, më 3 gusht 1914* 84
18. Informacion sekret i diplomatit austro-hungarez Kral, dërguar nga Durrësi, Ministrisë së Jashtme në Vjenë, për përgatitjen e një aksioni të rëndësishëm ushtarak të shqiptarëve ndaj Serbisë, në veri të vendit  
*Durrës, më 3 gusht 1914* 84
19. Informacion i Lövental-it , drejtuar nga Durrësi Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë për kthimin e kryeministrit shqiptar Turhan Pasha, nga një udhëtim jashtë vendit  
*Durrës, më 3 gusht 1914* 85
20. Informacion nga legata e Austro-Hungarisë në Durrës dhe nënkonsulli Mayerhauser nga Vlora, drejtuar ministrit të Jashtëm, Berchtold , për largimin e oficerëve holandezë nga Shqipëria  
*Vlorë, më 3 gusht 1914* 85

21. Informacion i nënkonsullit austro-hungarez, Hornbostel, drejtuar nga Janina Ministrisë së Jashtme në Vjenë për ndihmën e dhënë disa myslimanëve shqiptarë të sapodalë nga burgjet greke  
*Janinë, më 3 gusht 1914* 86
22. Informacion i Kryekomandës së Ushtrisë Perandorake Mbretërore, dërguar Ministrisë së Jashtme në Vjenë për tërheqjen e detashmentit austro-hungarez nga Shqipëria  
*Vjenë, më 3 gusht 1914* 87
23. Informacion nga diplomati i Austro-Hungarisë, konsulli i Përgjithshëm në Durrës, Kral, për emërimin e një funksionari të policisë italiane në Vlorë, pas caktimit të një funksionari austriak në policinë e Durrësit  
*Durrës, më 3 gusht 1914* 87
24. Lajmërimi i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, drejtuar konsullit Halla në Shkodër, për vendimin e tërheqjes së detashmentit nga Shkodra  
*Vjenë, më 3 gusht 1914* 88
25. Shkresë konfidenciale e ambasadës gjermane në Vjenë, drejtuar qeverisë austro-hungareze, për qëndrimin përfundimtar të saj në lidhje me angazhimin e detashmentit austriak në Shkodër, për mbrojtjen e Lezhës e Shëngjinit nga forcat e rebelëve të Shqipërisë së Mesme  
*Vjenë, më 3 gusht 1914* 88
26. Telegram nga Vjena, dërguar Lövental-it në Durrës dhe kontit Szögyenyi në Berlin, me të cilin në mënyrë tepër konfidenciale, informohen për situatën në Shqipëri pas deklaramit të luftës nga Austro-Hungaria ndaj Serbisë, dhe theksohet dëshira që Princi Wied të hynte në luftë me Serbinë nëse do të donte të mbante fronin  
*Vjenë, më 4 gusht 1914* 90
27. Telegram për konsullin austro-hungarez në Shkodër, Halla, me të cilin Ministria e Punëve të Jashtme informon se Komanda e Lartë Ushtarake e Austro-Hungarisë ka dhënë urdhrin për largimin nga Shqipëria  
*Vjenë, më 4 gusht 1914* 91

28. Telegram nga Vjena me njoftimin për vendosjen e kontaktit me kolonelin Mietzl me anë të Shkodrës  
*Vjenë, më 4 gusht 1914* 92
29. Shkresë konfidenciale e ministrit të akredituar në Durrës, Lövental, dërguar ministrit të Jashtëm Berchtold në Vjenë, në lidhje me një asistencë financiare për qeverinë shqiptare, që të mund të trajtojë vullnetarët rumunë  
*Durrës, më 4 gusht 1914* 92
30. Informacion nga Ministria e Punëve të Jashtme e Austro-Hungarisë, për diplomatët e vet në Durrës, se Italia do t'i qëndronte besnike akordeve të përfunduara me Austro-Hungarinë, si dhe vendimeve të Konferencës së Londrës  
*Vjenë, më 4 gusht 1914* 93
31. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, dërguar ambasadorit austriak në Romë, Mérey, dhe të dërguarit në Durrës, Lövental, me të cilin udhëzohen t'u shprehin kënaqësi autoriteteve e kolegëve italianë për deklaratat e Italisë se do të respektojë akordet midis dy vendeve për qëndrimin ndaj Shqipërisë por shprehet edhe dyshimi për një neutralitet të mundshëm midis detashmenteve ushtarake në Shkodër, pas shpalljes së luftës ndaj Serbisë  
*Vjenë, më 4 gusht 1914* 94
32. Telegram i nënkonsullit austriak në Vlorë Mayerhauser, drejtuar konsullit të Përgjithshëm në Durrës, Kral, ku e informon për marrjen prej tij të një shkresë me rëndësi, pas nisjes së Ismail Qemalit  
*Vlorë, më 4 gusht 1914* 95
33. Informacion i autoriteteve austro-hungareze në Trieste, dërguar konsullit të Përgjithshëm austriak në Shkodër, Zambauer që të ishte i kujdesshëm ndaj paraqitjes së projekteve ekonomike të A.Tarabokias për shkak të rezervave të Ministrisë së Punëve të Jashtme rreth figurës së tij  
*Vjenë, më 4 gusht 1914* 96

34. Buletin politik lidhur me Shqipërinë, pa të dhëna konkrete, ku bazuar dhe në të dhënat e pikëpamjet e një korrespondenti shqiptar të palës botuese, shprehej pikëpamja se nuk duhej nënvleftësuar e drejta e padiskutueshme e shqiptarëve për zbatimin e parimit të kombësive, se ato ishin kundër pushtimit të Shkodrës nga trupat malazeze e të Vlorës nga ato italiane dhe se kontrolli italian do të ishte hëpërhë më i pranuar nga shqiptarët, kur Shqipëria do të ishte ende qendra e shumë intrigave, përpara se të vendosej fati i saj  
*Lozanë, më 4 gusht 1914* 97
35. I dërguari austro-hungarez në Durrës, Lövental, informon ministrin e Jashtëm Berchtold , rreth dorëheqjes së misionit holandez në Shqipëri dhe për shkaqet e paraqitura prej tij  
*Durrës, më 4 gusht 1914* 99
36. Telegram i nënkonsullit austriak në Vlorë, Mayerhauser, dërguar Berchtold-it dhe konsullit Kral në Durrës, ku i informon për nisjen e Ismail Qemalit për në Romë  
*Vlorë, më 4 gusht 1914* 100
37. Telegram të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, drejtuar ministrit të akredituar në Athinë, Szilassy, për çështjen e Epirit  
*Vjenë, më 4 gusht 1914* 102
38. Telegram i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, drejtuar Lövental-it në Durrës, me të cilin e njofton se ishte vendosur largimi i detashmentit austriak nga Shkodra  
*Vjenë, më 4 gusht 1914* 103
39. Shkresë e Ministrisë së Luftës austro-hungareze, rreth komandantit të detashmentit austriak në Shkodër, nënkolonelit Lorn  
*4 gusht 1914* 103
40. Pjesë ditari të kolonelit Mietzl, efektiv në detashmentin austro-hungarez në Shkodër, me shënime nga udhëtimi i tij në disa zona në veri të Shqipërisë, që mbyllet me marshimin e 4 gushtit nga Shkodra në Barbullush 104

- 
- 4 gusht 1914 104
41. Shkresë e diplomatit austro-hungarez Lövental, dërguar nga Durrësi, ministrit Berchtold në Vjenë, në lidhje me disa të dhëna për situatën e Princ Wied-it  
*Durrës, më 5 gusht 1914* 105
42. Njoftim i të dërguarit të Austro-Hungarisë në Durrës, Lövental, drejtuar eprorëve, për telegramin nga Brindisi, që pohon mbërritjen atje të Karaseid Pashës  
*Brindisi, më 5 gusht 1914* 106
43. Lövental informon nga Durrësi ministrin e Jashtëm të Austro-Hungarisë, Berchtold, për anulimin e udhëtimit të fëmijëve të Princ Wied-it në Rumani për shkak të vështirësive që krijon situata e rënduar politike  
*Durrës, më 5 gusht 1914* 106
44. Telegram i Ministrisë së Jashtme austro-hungareze, drejtuar ambasadës gjermane në Vjenë, për largimin e detashmentit gjerman nga Shkodra  
*Vjenë, më 5 gusht 1914* 107
45. Raport i Lövental-it dërguar nga Durrësi ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, Berchtold, rreth politikës së Vjenës në Shqipëri e ndaj Princ Wied-it e krijuar në këto rrethana  
*Durrës, më 5 gusht 1914* 107
46. Telegram i konsullit të Përgjithshëm në Durrës, Kral, drejtuar Byrosë së Evidencës në lidhje me aksionin e dërgimit të armëve në Shëngjin  
*Durrës, më 6 gusht 1914* 110
47. Informacion konfidencial i nënkonsullit austro-hungarez në Janinë, Hornbostel, drejtuar ministrit të Jashtëm, Berchtold, rreth situatës atje, mbas fillimit të konfliktit të Austro-Hungarisë me Serbinë  
*Janinë, më 6 gusht 1914* 111

48. Informacion i të dërguarit të Austro-Hungarisë në Durrës, Lövental, drejtuar ministrit të Jashtëm në Vjenë, se për shkak të ngjarjeve politike në Shqipëri, ngritja e shërbimit telegrafik nuk kishte më vlerë aktuale  
*Durrës, më 6 gusht 1914* 112
49. Nënkonsulli i Austro-Hungarisë në Vlorë, Majerhauser, informon Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, për dërgimin e një raporti në legatën me seli në Durrës  
*Vlorë, më 6 gusht 1914* 112
50. Të dhëna të institucioneve tregtare austro-hungareze rreth situatës në marrëdhëniet tregtare me Shqipërinë  
*Vjenë, më 6 gusht 1914* 113
51. Pjesë nga ditari i kolonelit Mietzl, efektiv i detashmentit austro-hungarez në Shkodër, dërguar ministrit të Jashtëm, Berchtold, ku përshkruhet një marshim në veri të vendit i këtij detashmenti dhe një detashmenti italian, nga 18 korriku më 6 gusht 1914, së bashku me delegatët austro-hungarezë, italianë, gjermanë dhe anglezë  
*6 gusht 1914* 113
52. Informacion i Lövental-it dërguar ministrit të Jashtëm Berchtold, për një tratativë bisedimi të Hasan Prishtinës, Isa Boletinit dhe Bajram Currit me rebelët e Shqipërisë së Mesme  
*Durrës, më 6 gusht 1914* 115
53. Informacion i Lövental-it, drejtuar ministrit të Jashtëm Berchtold, rreth trupave vullnetare shqiptare dhe të huaja që mbrojnë Durrësin nga rebelët  
*Durrës, më 6 gusht 1914* 115
54. Informacion i Lövental-it drejtuar ministrit të Jashtëm austro-hungarez, Berchtold, për shpenzimet rreth shërbimit sanitar të shqiptarëve në Trieste  
*Durrës, më 6 gusht 1914* 117
55. Njoftim i gjeneralit Conrad, dërguar nga Ministria e Luftës e Austro-Hungarisë, për strukturat ushtarake perandorake në nivele të ndryshme, që



- përmban njoftimin telegrafik të detashmentit austro-hungarez të dislokuar në Shkodër, se detashmenti britanik dhe koloneli Phillips janë larguar drejt Maltës  
*Shkodër, më 6 gusht 1914* 118
56.  
 Telegram i kolonelit austro-hungarez Mietzl, drejtuar Ministrisë së Luftës në Vjenë, për largimin e detashmentit austro-hungarez dhe gjerman nga Shqipëria  
*Kastelnuovo, më 6 gusht 1914* 118
57.  
 Shkresë e princit të Lihtejnshajnit, në emër të Komitetit të Shqipërisë, në Vjenë, ku e informon se ndihmat ushqimore për refugjatët në Shqipërinë e Veriut, nuk do të dërgohen për shkak të vonesave në transport dhe rritjes ndërkohë të çmimeve  
*Vjenë, më 6 gusht 1914* 119
58.  
 Shkresë e komisarit austro-hungarez Kral, dërguar nga Durrësi, ministrit të Jashtëm Berchtold, për shqyrtimin e situatës së rëndë në Kelmend  
*Durrës, më 6 gusht 1914* 120
59.  
 Telegram i komandës së flotës ushtarake të Austro-Hungarisë në gjirin e Kotorrit, i shpërndarë nga Ministria e Luftës, i cili përmban njoftimin për largimin e oficerëve holandezë nga Shqipëria, të fëmijëve të Princ Wied-it për në Rumani, si dhe për disa lëvizje të anijeve ushtarake  
*Kastelnuovo, më 6 gusht 1914* 120
60.  
 Shkresë e komisarit austro-hungarez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, Kral, me të cilën njofton për largimin në Berlin të përfaqësuesit gjerman në këtë Komision, si dhe për shpërndarjen e afërt të tij, për shkak të gjendjes së luftës  
*Durrës, më 6 gusht 1914* 121
61.  
 Telegram i konsullit të Përgjithshëm të Austro-Hungarisë, Rappaport, drejtuar përfaqësuesit austro-hungarez në Janinë, Hornborstel, për një prani të mëtejshme të tij në atë qytet  
*Vjenë, më 6 gusht 1914* 122

62. Shkresë e Ministrisë së Luftës, që njofton për festimin e ditëlindjes së perandorit Franz Joseph në detashmentin austro-hungarez në Shkodër  
*Vjenë, më 6 gusht 1914* 123
63. Telegram i përfaqësuesit të Austro-Hungarisë në Durrës, Lövental, dërguar ministrit të Jashtëm, Berchtold, për marrjen e një memororie  
*Durrës, më 6 gusht 1914* 123
64. Telegram i ministrit të Jashtëm, Berchtold, drejtuar ambasadorit austro-hungarez në Romë, Mérey, që udhëzon të njoftohet qeveria italiane për largimin e detashmentit austriak nga Shkodra  
*Vjenë, më 6 gusht 1914* 124
65. Shkresë e kthyer në Ministrinë e Luftës, që përmban lajmin për goditje me armë afër radiostacionit në Shkodër, të ndodhur më 7 korrik 1914  
*Vjenë, më 6 gusht 1914* 124
66. Telegram i një grupi kundërshtar të Ismail Qemalit, i cili shfaqet si përfaqësues i refugjatëve shqiptarë të mbledhur në rrethinat e Vlorës. Ai denoncon mizoritë e shumta greke në Shqipërinë e Jugut, kërkon ndihma dhe shpreh besnikërinë ndaj Princ Wied-it  
*Vlorë, më 7 gusht 1914* 125
- Pjesë e një telegrami drejtuar Fuqive të Mëdha, nga Komiteti i Shpëtimit Publik në Vlorë, drejtuar nga Ismail Qemali, ku kërkohet respektimi i Protokollit të Londrës për Shqipërinë dhe vënia para përgjegjësive të autorëve të mizorive greke në jug të vendit, i cili gjendet bashkangjitur me telegramin e refugjatëve shqiptarë në Janinë  
*Vlorë, më 26 korrik 1914* 127
67. Deklaratë e disa përfaqësuesve të popullsisë së krahinave të jugut, të shkatërruara nga ushtritë greke e të strehuar në Vlorë, dërguar Fuqive të Mëdha, me të cilën shpallin se nuk e njohin Ismail Qemalin, si përfaqësues të kauzës së tyre  
*Vlorë, më 7 gusht 1914* 128

68. Informacion i nënkonsullit Hornbostel nga Janina, lidhur me miratimin e Protokollit të Korfuzit, të cilin Vjena ia përcjell Mérey-t në Romë dhe Lövental-it në Durrës  
*Vjenë, më 7 gusht 1914* 128
69. Shkresë e konsullatës së Përgjithshme austriake në Janinë, drejtuar ministrit të Jashtëm Berchtold, për rrjedhojat e Marrëveshjes së Korfuzit në jug të vendit dhe për shfrytëzimin e një destabilizimi të mëtejshëm nga qarqet shoviniste greke për synimet e tyre për aneksimin e Shqipërisë së Jugut  
*Janinë, më 7 gusht 1914* 129
70. Njoftim i të dërguarit perandorak të Austro-Hungarisë në Hagë, Giskra, për kontin Berchtold, me të cilën bashkëngjijt një notë të Ministrisë së Mbretërisë së Holandës për lirim të dy oficerëve holandezë të zënë rob  
*7 gusht, 1914* 130
71. Telegram i nënkonsullit austriak Hornbostel drejtuar nga Janina, ministrit të Jashtëm Berchtold dhe legatës së Austro-Hungarisë në Athinë, për qëndrimin e kolegut italian aty dhe rreth privacioneve të popullsisë myslimane të Gjirokastrës  
*Janinë, më 7 gusht 1914* 131
72. Shkresë e Ministrisë së Jashtme austriake, dërguar Lövental-it në Durrës, për hetime rreth çështjes së varreve malazeze në Shqipërinë e Veriut  
*Vjenë, më 7 gusht 1914* 132
73. Informacion i Seksionit të Marinës, rreth një raporti të Misionit të Komandës së Flotiljes së Kryqëzorëve në Durrës  
*Durrës, më 7 gusht 1914* 132
74. Nënkonsullata austro-hungareze e Brindisit, informon ministrin e Jashtëm Berchtold në Vjenë, për dhënien e lejes rumunit Dyngern, që të udhëtojë në Shqipëri ku do të takohet me Princ Wied-in, me porosi nga Mbretëresha e Rumanisë  
*Brindisi, më 7 gusht 1914* 133

75.  
Raport i të dërguarit austriak në Durrës Lövental, paraqitur ministrit të Jashtëm Berchtold, rreth situatës së Princ Wied-it, lëvizjes së Kosovës, veprimeve të rebelëve të Shqipërisë së Mesme, si dhe për qëndrimin e italianëve  
*Durrës, më 7 gusht 1914* 134
76.  
Letër e profesorit rumun baronit Dyngern, drejtuar nënkonsullit austro-hungarez në Brindisi, për leje udhëtimi drejt Durrësit, me një porosi konfidenciale për Princ Wied-in  
*Brindisi, më 7 gusht 1914* 135
77.  
Informacion i ambasadorit austro-hungarez në Romë, Mérey, drejtuar ministrit të Jashtëm Berchtold, për çështjen e përcaktimit të kufirit të Shqipërisë me Malin e Zi dhe qëndrimin e Italisë  
*Romë, më 7 gusht 1914* 136
78.  
Informacion i nënkonsullit austro-hungarez në Janinë, Hornbostel, për ministrin e Jashtëm në Vjenë dhe ministrin e akredituar në legatën austro-hungareze në Athinë, rreth një dislokimi të mundshëm të dy regjimenteve greke në Prevezë  
*Janinë, më 7 gusht 1914* 137
79.  
Notë e legatës mbretërore serbe në Durrës, drejtuar nga Gavriloviç Kryeministrit Turhan Pasha, për një ekspeditë të armatosur të Hasan Prishtinës ndaj Serbisë  
*Durrës, më 7 gusht 1914* 138
80.  
Të dhëna jo të plota rreth transportimit të detashmentit francez në Shkodër, me një vapor italian, me garancinë e Austro-Hungarisë  
*Vjenë, më 8 gusht 1914* 139
81.  
Shkresë dërguar ambasadorit Szögyenyi në Berlin nga Ministria e Jashtme në Vjenë, rreth qëndrimit gjerman për transportimin e detashmentit francez nga Shkodra  
*Vjenë, më 8 gusht 1914* 139

82. Shkresë e Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, dërguar Kryekomandës Ushtarake për sigurimin e transportit të detashmentit francez, së bashku me mendimin ligjor përkatës  
*Vjenë, më 8 gusht 1914* 140
83. Shkresë e nënkonsullit të Austro-Hungarisë në Vlorë, Mayerhauser, rreth një telegrami nga një grup emigrantësh shqiptarë të Shqipërisë së Jugut, drejtuar qeverive evropiane ku e shpallin Ismail Qemalin të paautorizuar prej tyre  
*Vlorë, më 8 gusht 1914* 141
84. Shkresë e nënkonsullit austro-hungarez në Vlorë, Mayerhauser, dërguar legatës austriake në Durrës, shoqëruar me një raport  
*Vlorë, më 8 gusht 1914* 141
85. Shkresë e Seksionit të Marinës së kryqëzorëve, me një raport të Komandës së flotiljes së kryqëzorëve austriakë  
*8 gusht 1914* 142
86. Telegram i ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, Berchtold, dërguar konsullit të Përgjithshëm Kral në Durrës, për zgjatjen e transaksioneve për Pashalimanin me Syrja e Eqrem Bej Vlorën  
*Vjenë, më 8 gusht 1914* 142
87. Shkresë e nënkonsullatës austro-hungareze në Brindisi, drejtuar Ministrisë së Jashtme, për vështirësitë e rumunit, baronit Dyngern drejt Durrësit  
*Brindisi, më 8 gusht 1914* 143
88. Raport konfidencial i konsullit të Austro-Hungarisë në Korfuz, Para, drejtuar Berchtold-it, në lidhje me udhëtimin e Princ Wied-it në Vlorë dhe situatën në Shqipëri, në rast të një abdikimi të tij në këto momente  
*Korfuz, më 8 [?] gusht 1914* 143
89. Telegram nga konsullata në Bari, drejtuar Kral-it në Durrës, rreth mundësisë së udhëtimit të disa oficerëve austriakë për në këtë qytet  
*Durrës, më 8 gusht 1914* 145

90.  
Telegram i markezit Pallavicini, lidhur me planin për kryengritje të shqiptarëve në “Serbisë së Re”, që donin të organizonin autoritetet osmane  
*Jenikoj, më 8 gusht 1914* 145
91.  
Telegram nga konsullata e Austro-Hungarisë në Korfuz, drejtuar ambasadorit në Stamboll, Pallavicini, lidhur me mundësinë e ndihmës nga shqiptarë të Çamërisë e të malësorëve shqiptarë, për të sulmuar Serbinë  
*Korfuz, më 8 gusht 1914* 146
92.  
Telegram i Kral-it drejtuar qeverisë vjeneze, në lidhje me një protestë të ministrit serb të akredituar në Durrës, paraqitur kryeministrit Turhan Pasha, për një ekspeditë të armatosur të Hasan Prishtinës ndaj Serbisë dhe shkeljen e neutralitetit nga Shqipëria  
*Durrës, më 8 gusht 1914* 146
93.  
Informacion i përfaqësuesit të Austro-Hungarisë në Durrës, Lövental, drejtuar ministrit të Jashtëm Berchtold, për notën e ministrit serb të akredituar aty, drejtuar Kryeministrit Turhan Pasha, në lidhje me një ekspeditë të armatosur të Hasan Prishtinës ndaj kufirit serb  
*Durrës, më 8 gusht 1914* 147
94.  
Informacion i kondraadmiralit austro-hungarez Barri, drejtuar Ministrisë së Luftës, për ankesat e fisit Mërturaj dhe të Mirditës, në Komisionin Ndërkombëtar në Shkodër, lidhur me pengesat e Serbisë për tregti në Gjakovë dhe rreth pushtimit të Oroshit  
*Vjenë, më 9 gusht 1914* 148
95.  
Kryekomanda e Ushtrisë austro-hungareze, informon Ministrinë e Luftës në Vjenë me një telegram të firmosur nga gjenerali Conrad, për një nisje të shpejtë të dy detashmenteve në Shkodër, atij austriak dhe atij gjerman  
*Vjenë, më 9 gusht 1914* 148
96.  
Telegram i ministrit të Jashtëm, Berchtold, drejtuar ambasadorit Mérey në Romë, me njoftimin se përgjithësisht në Epir, flamuri autonom u zëvendësua me atë të Greqisë  
*Vjenë, më 9 gusht 1914* 149

97.  
Korrespondencë e Ministrisë së Jashtme austro-hungareze me përfaqësinë diplomatike në Athinë rreth problemit të mbështetjes me ndihma për shqiptarët e vobektë  
*Vjenë, më 9 gusht 1914* 149
98.  
Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Halla, lidhur me njoftimin e lajmit të marrë nga baron Franz Nopcsa për pushtimin e Bregut të Matit nga rebelët dhe Hasan Prishtina me pasues të tij  
*Shkodër, më 9 gusht 1914* 150
99.  
Notë e Ministrisë Shqiptare të Punëve të Jashtme, drejtuar ministrit të Serbisë të akredituar në Durrës, për çështjen e largimit të Hasan Prishtinës drejt kufirit serb pa autorizimin e qeverisë shqiptare dhe asnjë furnizim prej saj me municion lufte  
*Durrës, më 9 gusht 1914* 151
100.  
Notë e dytë e ministrit serb të akredituar, Gavriloviç, me porosi të mbretit serb, drejtuar Kryeministrit e ministrit të Jashtëm shqiptar, Turhan Pashës, për të ndaluar mësymjet e kufirit serb nga territori shqiptar  
*Durrës, më 9 gusht 1914* 151
101.  
Telegram i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, dërguar konsullit të Përgjithshëm Kral në Durrës, Mérey-t në Romë dhe Szögyenyi në Berlin, për mospranimin e pikëpamjes ruse për tërheqjen e anëtarëve të KNK dhe për qëndrimin e mëtejshëm të komisarit austriak aty  
*Vjenë, më 10 gusht 1914* 152
102.  
Informacion i të dërguarit austro-hungarez në Durrës, Lövental, për Berchtold-in në Vjenë, rreth dy notave të qeverisë serbe drejtuar Turhan Pashës për ndalimin e mësymjeve ndaj kufirit serb nga territori shqiptar  
*Durrës, më 10 gusht 1914* 153
103.  
Informacion i kryekonsullit austro-hungarez, Kral, për qëndrimin në Durrës të Bajram Currit e Isa Boletinit, në mbrojtje të qytetit  
*Durrës, më 10 gusht 1914* 154

104.  
Shkresë e Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, drejtuar konsullit të Përgjithshëm Kral në Durrës, për organizimin e një lëvizjeje nga Shqipëria kundër Serbisë  
*Vjenë, më 10 gusht 1914* 154
105.  
Raport i detajuar i diplomatëve austriakë, rreth gjendjes së vajtueshme e tepër të ndërlikuar në Shqipëri, ndërkohë që Princ Wied-i dhe qeveria shqiptare nuk kanë mundësi për asnjë veprim  
*Durrës, më 10 gusht 1914* 155
106.  
Shkresë e të dërguarit të Austro-Hungarisë në Durrës, Lövental, dërguar ministrit Berchtold në Vjenë, rreth një një pagese për Marka Gjonin, me autorizimin e tij  
*Durrës, më 11 gusht 1914* 158
107.  
Raportimi i të dërguarit Lövental në Durrës, ministrit të Jashtëm Bertchold në Vjenë, për emërimin e Myfit Bej Libohovës si ministër i akredituar në legatën e Shqipërisë në Itali, shoqëruar me opinionin rreth personalitetit e pikëpamjeve të tij  
*Durrës, më 11 gusht 1914* 159
108.  
Shtojcë e raportit të Lövental-it të 11 gushtit 1914, dërguar Berchtold-it me të dhëna të biografisë personale të Myfit Bej Libohovës  
*Durrës, më 11 gusht 1914* 161
109.  
Telegram i konsullit të Përgjithshëm Kral, rreth një kryengritjeje të Përgjithshme në Kosovë, paralel me avancimin e Austro-Hungarisë dhe kundrejt garancisë së bashkimit të tyre me Shqipërinë, pas çlirimit nga Serbia  
*Vlorë, më 11 gusht 1914* 162
110.  
Telegram i të dërguarit të Austro-Hungarisë në Durrës, Lövental, dërguar Berchtold-it, rreth kërkesave të ambasadorit serb në Durrës, për marrjen e masave nga qeveria shqiptare, që të ndalohen sulmet e shqiptarëve kosovarë në kufi me Serbinë  
*Durrës, më 11 gusht 1914* 163



111.  
Letër e Krajevski-t, kryetar i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, dërguar Zografos-it dhe A.Karapanos-it lidhur me protokollin e Korfuzit dhe zbatimin e saj, sipas garancisë së Fuqive të Mëdha  
*Durrës, më 11 gusht 1914* 163
112.  
Informacion i të dërguarit të Austro-Hungarisë në Durrës, Lövental, dërguar ministrit të Jashtëm në Vjenë, rreth bisedimeve me rebelët të një dërgate durrsakësh esadistë, të kryesuar nga malazezi Gjurashković dhe kërkesat e tyre për abdikimin e Wied-it  
*Durrës, më 11 gusht 1914* 164
113.  
Shkresë e të dërguarit të Austro-Hungarisë në Durrës, Lövental, dërguar Berchtold-it në Vjenë, rreth fjalëve të përhapura se Esat Pashë Toptani mund të ishte në Shijak  
*Durrës, më 11 gusht 1914* 165
114.  
Telegram nga Ministria e Jashtme në Vjenë, drejtuar konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Durrës, Kral, me udhëzime se një marrëveshje me rebelët mund të ishte më e përshtatshme në këto momente  
*Vjenë, më 11 gusht 1914* 166
115.  
Shkresë e Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, drejtuar Lövental-it në Durrës, për pezullimin e disa ndihmave për refugjatët në Shqipëri  
*Vjenë, më 11 gusht 1914* 167
116.  
Shkresë përcjellëse për një notë të Ministrisë së Tregtisë të Austro-Hungarisë e përfaqësuesit në Durrës, Lövental, dërguar ministrit Berchtold në Vjenë  
*Durrës, më 11 gusht 1914* 167
117.  
Telegram i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë dërguar konsullit të Përgjithshëm në Durrës, Kral, për korrespondencën e saj me ambasadën austriake në Romë të datës 10 gusht 1914  
*Vjenë, më 11 gusht 1914* 168

118.  
Telegram i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, dërguar kryekonsullit Kral në Shqipëri, me udhëzimin që të nxisë udhëheqësit kosovarë për një përfshirje të armatosur, krahas trupave austro-hungareze kundër Serbisë  
*Vjenë, më 11 gusht 1914* 168
119.  
Komisari austro-hungarez pranë KNK, Kral, informon nga Durrësi Ministrinë e Jashtme në Vjenë, ambasadën në Romë dhe legatën në Durrës se zbatimi i Marrëveshjes së Korfuzit, paraqet shumë vështirësi për shkak të qëndrimit të Zografos-it dhe "Kongresit Vorioepirot"  
*Durrës, më 12 gusht 1914* 169
120.  
Informacion i Kral-it, dërguar Komandës Eprore të Armatës, që të urdhërohen oficerët e një misioni ushtarak, që të shkojnë në Shqipëri  
*Vlorë, më 12 gusht 1914* 171
121.  
Raport i të dërguarit të Austro-Hungarisë në Durrës, Lövental, dërguar ministrit të Jashtëm Berchtold lidhur me vështirësitë që paraqet lëvizja e armatosur e shqiptarëve kosovarë kundër Serbisë  
*Durrës, më 12 gusht 1914* 172
122.  
Raport i nënkonsullit Mayerhauser drejtuar nga Vlora ministrit të Jashtëm Berchtold, rreth marrjes së Beratit nga forcat qeveritare dhe ripushtimin nga rebelët  
*Vlorë, më 12 gusht 1914* 173
123.  
Telegram i Ministrisë së Jashtme drejtuar komandës së ushtrisë austro-hungareze dhe konsullit të Përgjithshëm në Durrës Kral, për shpenzimet e 225.000 koronave për nxitjen e një kryengritjeje në Serbinë e Re  
*Vjenë, më 12 gusht 1914* 175
124.  
